



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok

Municipal Assembly Istog

Komitetit për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

29	<b>P r o c e s v e r b a l</b>
<b>Tipi i mbledhjes:</b>	Mbledhje e rregullt e KPF-së
<b>Data e mbajtjes:</b>	21.09.2020, në ora 10:00
<b>Mbledhjen e kryesoi:</b>	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
<b>Procesmbajtës:</b>	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lart për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës së Istogut
<b>Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së</b>	Zenel Shatri, Besa Ferati, Haki Podrimaj, Eliot Kukiqi, Ajshe Metaj dhe Ardita Idrizaj
<b>Mungojnë:</b>	
<b>Pjesëmarrës të tjerë:</b>	Kryetari i Komunës, z. Haki Rugova, Drejtorat: Hysni Maxharraj, Mujë Osmanaj, Drin Sadikaj, Lulzim Blakaj, Demë Qeta, Zyrtar Administrativ: Genc Ademaj, Flora Bujupaj, Fjolle Berisha.
<b>Rendi i ditës:</b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Konstatimi i prezencës së anëtareve të Komitetit,</li> <li>2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,</li> <li>3. Shqyrtimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, dhe njoftimi me Planin e veprimit për mënjanimin e të gjeturave,</li> <li>4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020-2021,</li> <li>5. Shqyrtimi i Projekt-Buxhetit të komunës për periudhën 2021-2023,</li> <li>6. Marrja e vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për vitin shkollor?</li> <li>7. Shqyrtimi i kërkesës nr.00-016-2391/8 të datës 17.08.2020 nga K.R.M.- " Ambienti" - Istog.</li> </ol>	
<b>Diskutimet:</b>	
<p><b>Kryesuesi</b> z. Qaush Balaj, përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje. Në mbrojtje të infektimit nga pandemia dhe respektimit të masave ndaj virusit Covid 19, Salla që jemi tani është dezinfektuar, anëtarët e komitetit si dhe të pranishmit tjera janë pajisur me maska, doreza dhe dezinfektues në tavolina.</p> <p>Hapë punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.</p> <p>Prezanton rendin e ditës,</p>	

Fton Ekzekutivin si dhe Anëtarët e KPF-së nëse dikush ka ndonjë pyetje sugjerim apo ndonjë propozim për rend dite?

Hedhe në miratim Rendin e ditës

Miratohet në shumicë të thjeshtë.

**Kryetari i Komunës** - përshëndet të gjithë të pranishmit, dhe ju dëshiron punë të pa lodhshme në mbledhje, kërkon falje se për pak kohë duhet të dal nga mbledhja sepse kam një takim dhe kthehem shpejtë.

**Vendimet:**

**Miratohet njëzëri rendi i ditës, me këtë propozim nga Ekzekutivi.**

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

#### Shqyrtimi i pikës 1.

**Diskutimet:**

**Kryesuesi** - Konstatimi i prezencës së anëtareve të Kuvendit, Konstatoj që të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë e Financa janë prezentë në këtë mbledhje, dhe mund të fillojmë me pikat në vazhdim.

**Vendimet:**

Vazhdojmë me mbledhjen

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

#### Shqyrtimi i pikës 2.

**Diskutimet:**

**Kryesuesi**, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni.

a ka dikush t diçka.

Pasi që diskutime nuk patë hedh në miratim.

**Vendimet:**

**Miratohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.**

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

#### Shqyrtimi i pikës 3.

**Diskutimet:**

**Kryesuesi**, vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, dhe njoftimi me Planin e veprimit për mënjanimin e të gjeturave, fjalën ja kalon drejtorit z. Hysni Maxharraj.

**Hysni Maxharraj** - përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e i raportit

të Zyrës Kombëtare të Auditimit, dhe njoftimi me Planin e veprimit për mënjanimin e të gjeturave.

**Ajshe Metaj** – përshëndet të gjithë të pranishmit, me vjen mirë se edhe kësaj radhe raporti i auditimit të ka opinionin e pa modifikuar, por prej se e shohim klasifikimin jo adekuat me krah klasifikimi i shpenzimeve është i pranishëm ajo çka me ka bërë me se shumti përshtypje, janë paguar dhe regjistruar shpenzimet nga 7608 euro ku 11622 janë paguar nga thesari ndërsa janë paguar edhe disa mjete tjera me nga gjykata ose përmes përmbaruesve nga kjo qe e kemi par i kanë marr nga madhrrat dhe shërbimet 4122 mirë po ajo që mesë shumti me ka bërë përshtypje këtu ku thuhet janë shpenzuar edhe një pjesë e mjeteve me rastin e daljes së punëtorëve në pension edhe të mësimdhënësve një pjesë e parave janë marr nga pagat jubilarë, kjo me ka bër shumë përshtypje.

**Eliot Kukiqi** – përshëndet të gjithë të pranishmit, kam një shqetësim të pronat, kjo dhënia me qera e pronave dhe inkasimi i tyre po shkon duke u përsëritur. Pse po ndodhë kjo drejtori tha se është formua një komision a ka mundësi me i dit emrat kush është në atë komision.

**Hysni Maxharraj** – faktikisht unë vetëm se jam përgjigjur në këto dy pyetje për vendime gjyqësorë të përmbaruesit, ku do të thotë se kemi një ranje të madhe. Inkasimi i mjeteve mund të bëhet nëse ne si organizatë buxhetore nuk ju japim një drejtim ata i marrin vet ku ti gjejnë mjetet e lira. Eliot nuk jam kompetent ti them emrat e komisionit po as nuk i di mirë se kush është në atë komision.

**Ajshe Metaj** – u tha që mjetet janë marr nga pagat jubilarë vetëm kjo këtu po shkruan ashtu.

**Hysni Maxharraj** – e kam këtu në tabelën B5 përmes vendimeve gjyqësorë, Rekomandimi B5 thotë Kryetari duhet të siguroj të bëhet planifikim i mirëfilltë i buxhetit duke forcuar disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë dhe të marr masat e duhura për menaxhimin e masave të duhura për proceset dhe ti bartin obligimet shtesë. Kam edhe raportin e auditimit me gjerësisht ne i kemi nxjerr rekomandimet.

**Zenel Shatri** - përshëndet të gjithë të pranishmit, dua ta di kur të tërhiqen këto mjete nga përmbaruesit e humb komuna?

**Hysni Maxharraj** - po komuna humb.

**Zenel Shatri** – pra ju kisha lut që të jeni me të kujdesshëm, kemi plot raste dhe koleg ton se siç tha edhe Ajshja këto mjete i kanë marr përmes gjykatës. Apeloj që të bëjnë kujdes në të ardhmen, mos të ketë raste të tilla.

**Hysni Maxharraj** – u përmend aty që një shpenzim ka shkuar përmes thesarit 7500 euro e ky është reagim jonë qe e kemi bërë për mos me u dëmtuar komuna. Deshat një rast konkret një shembull që ne kemi reagu me kohë kemi intervenuar te thesarin ku borxhin prej 7500 euro dhe nuk ka humb komuna diçka tjetër. Këto vendime që vine përmes gjykate me vendim të prerë ka mjete tjera shtesë që shkojnë në dem të komunës.

**Eliot Kukiqi** – drejtori na ka thënë se nuk ka kod për këto pagat jubilarë, mund të qesin mjete dhe m përmbaruesi ku të dëshiron.

**Hysni Maxharraj** – thash se përmbaruesi merr ku të gjen mjete të lira.

**Kryesuesi** – pasi që diskutime tjera nuk ka, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës

Nga anëtarët e KPF-së miratohet unanim,

Vendimet:

Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja në mënyre unanime: Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, dhe njoftimi me Planin e veprimit për mënjanimin e të gjeturave, ia kalohet KK-së për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

#### Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020-2021. Fjalën ja kalon Drejtorit Hysni Maxharraj.

Hysni Maxharraj - prezanton dhe sqaron, Vendimin për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020-2021.

Kryesuesi - Pyetje nëse ka dikush nga anëtarët e KPF-së ndonjë pyetje, pasi që askush nuk u lajmëruar. A mund ta bëje një pyetje unë? Po me intereson për njësit komerciale të objektit kemi 0.20% dhe për njësit industriale të objekteve po ashtu e kemi 0.20% a na lejon ligji që kjo të zvogëlohet, apo është e fundit minimalja.

Hysni Maxharraj -- këto tarifa janë të gjitha minimalet vetëm nëse doni ti ngrisni këto norma mundë të ndërhyjë.

Kryesuesi - pasi që diskutime tjera nuk ka, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës  
Nga anëtarët e KPF-së miratohet unanim,

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Propozim - Vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020-2021. si dhe i njëjti i kalohet KK-së për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

#### Shqyrtimi i pikës 5.

Diskutimet:

Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës, Shqyrtimi i Projekt-Buxhetit të komunës për periudhën 2021-2023. Fjalën ja kalon Drejtorit : Hysni Maxharraj

Hysni Maxharraj - bën prezantimin dhe sqarimin e Projekt-Buxhetit të komunës për periudhën 2021-2023.

Genc Ademaj, Zyrtar - përshëndet të gjithë të pranishmit, prezanton dhe sqaron procedurat nga

ministra për Projekt-Buxhetit të komunës për periudhën 2021-2023.

**Zenel Shatri** – janë disa projekte shumë me rendësi, në fshatin Tomoc në lagjen Bregu dhe lagja Imeraj ndërtimi i kanalizimit, a ka pasur mundësi ato me i shku në projekte tjera, pasi që në vitin 2021 nuk janë kur do të jen këto dy projekte, kërkoj që mundësisht të shikohet dhe të këqyret a kemi mundësi të bëjmë kanalizimin e atyre dy lagjeve.

Lagja e Bregut që dy a tri here jemi duke e kërkuar dhe u është premtuar fshatarëve se do të përfundoj, nuk e kemi kryer edhe lagjen Imeraj.

**Ajshe Metaj** – jemi në hartim të një projekti na shkolla si shkollë, rreth një ndërtimit të një bufeje d.m.th në shkollë që do të jetë aneks i shkollës , nuk di Kryetari a ka informacion për këta apo jo po kisha propozu, në mënyre që nxënëset mos na dalin neper rrugë mos na humbasin orë mos krijojnë mungesa të paarsyeshme, për ushqim , e kemi këtë kërkesë na Gjumnazi " Haxhi Zeka" se di a mundën me bo diçka në këtë drejtim .

**Eliot Kukiqi** Përshëndetje për te gjithë te pranishmit këtë material nuk e kemi pas nuk kemi muajt me analizua, tash nuk mujm me dhanë propozimet, tona se di qysh a ka me kanë dëgjim publik me qytetar dhe komision mbledh prapë apo qysh ka me kanë se na smujm me dhanë propozimet, se si nuk e kemi pas materialin, nuk dimë cilat janë prioritetet për vitin 2021 smujm me shku me teje.

**Kryesuesi** – prioritetet për vitin 2021 i lexojë Genci

**Genç Ademaj**- materialin nuk e keni pas në dispozicion është e vertetë , për shkakë që e ceku edhe Drejtori më herët, për shakë të shkresës që ka bë Ministria e Financave që do të jetë një afate, me zgjatur por ajo nuk ka ndodhur d.m.th është mbetur data 30 që na duhet me u përgatit.

**Eliot Kukiqi** – po thamë a kemi gjasë me majtë edhe një komision edhe me pa na materialin dhe me shqyrtuar me mirë se unë nuk di cilat propozimet janë hyrë në vitin 2021 se di me një të lexume smuj me majtë mënde.

**Kryesuesi** – ky është materiali na sipas procedurave, do të vazhdojmë me një dëgjime me qytetar, ku do të dëgjojmë edhe propozimet, e qytetarëve edhe pas atyre dëgjimeve do ta kemi një mbledhje të komunitetit, në dëgjimin me qytetarë do të jeni edhe ju si anëtarë i komitetit , edhe anëtare e kuvendit por vetëm do të dëgjojmë , propozimet dhe pas dëgjimeve do ta takohemi si Komitet , dhe pas asaj do të kalojmë në Kuvend për miratim , kjo është procedurë materiali është ky që është këtu që e prezantoj Genci .

**Eliot Kukiqi** - kemi mundësi me pas edhe na me pas me analizua ma mirë cilat janë prioritet , tash paska mu bo dëgjimi publik me qytetarë , tani edhe komisioni ndoshta aty na jepet mundësia me dhëne naje propozim, se sot nuk mut te jep se nuk di që ka aty pa e pa materialin dhe atë e kërkoja edhe unë.

**Haki Podrimaj** – faleminderit kryesuese përshëndetje për te gjithë, sa mujta me pa në material është një rrugë është një rrugë 1200 m “Rexhë Kastrati” që ka mundësi me e inkorporu edhe këtë rrugë për vitin 2021 kish qenë mirë.

**Kryetari i Komunës** – vetë për Ajshen, ju si staf i shkollës mund ta ndërtoni byfen në oborrin e shkollës ta bëni përshkrimin për objekt ta qitni tenderin , tok ka të mjaftueshmen, vendin e keni, hapeni procedurat vjen

dikush privat aplikon i plotëson kushtet dhe mund ta marrë, mos lypni nga Komuna.

**Ajshe Metaj** – kryetar unë veç propozim e bëra, se është në interes të këtyre fëmijëve.

**Kryetari i Komunës** – po këtë propozim nuk ka nevojë me e shti në listë të projekteve sepse shkolla në vet iniciativ mund ta bëjë këtë, sepse këtu nuk ka nevojë për, aty kush ka interes e punon, shpallet ankandë aty vetëm bënë projektin çka mënoni me u ndërtua aty ( e bëni përshkrimin çka do të këtë aty dhe çka nuk do të këtë, për personelin dhe për stafin arsimor).

**Ajshe Metaj** - ne kryetar i kemi provoat tona që nxënësit dalin me marr ushqim dhe vonohen gati gjysmë ora dhe kur të vijë pengojnë.

**Kryetari i Komunës** – kurrë nuk ju kom ndalu vendin me të mirë, as një shkollë nuk e ka si gjimnazi i Istogut. Buxheti për këtë vit është pak me ndryshe, Drejtori i buxhetit ju sqaron.

**Hysni Maxharraj** – fjala është për 10 milionëshin që ka ndarë Qeveria. Ne na ka ardhur një imel nga ministria përkatëse që ne jemi detyruar që në afat rekord tua kthejmë imelen që ku do ti alokojmë këto mjete pra në konsultim me Kryetarin dhe të gjithë koleget 100 mijë euro e kemi bërë kërkesën që të alokohen në arsim në menaxhim të pandemisë pra në mallra dhe shërbime, 100 mijë euro në shërbime publike ku 35 mijë euro prej tyre përkrahje të Stacionit të Autobusëve dhe 65 mijë euro në mallra dhe shërbime 50 mijë euro në shëndetësi 20 mijë euro në subvencione dhe 30 mijë në mallra dhe shërbime dhe 15651 të zyra e kryetarit subvencione për përkrahjen e rasteve të ndryshme individuale. Të gjitha të parapara për menaxhimin e pandemisë. Disa i kemi dërguar në subvencione disa në mallra dhe shërbime për mos me i dërgua mjetet në suficit.

**Kryetari i Komunës** -- nëpër shkolla do të mundohemi që të i paistim me mjete mbrojtëse dhe me iped apo llaptop.

**Zenel Shatri** – tash pritet edhe një valë e dytë, a janë të mjaftueshme për shëndetësi 50 mijë a kini marr far parallogarish. Mendoj që shëndetësia e Istogut e ka kryer një punë të shkëlqyeshme fal këtij shtabit, edhe kryetari ka qenë gjithnjë shumë i gatshëm jo tash por prej se e mbajë mend për shëndetësi ka qen i gatshëm me kontribu nga fondet e veta, a keni marr far planifikimi që mos me mbet nesër me pas një epidemi me i pas mjetet. Unë po e shoh që edhe në Pejë atje jam edhe anëtar i shtabit atje kanë nis me na u hargjuar mjetet Kryetar për shembull do ampula që na duhen ndonjëherë po i qojmë e po i dhëm në shtëpi të shëndetit në qendrat kryesore familjare.

**Hysni Maxharraj** – e kemi shikuar doktor edhe këtë nga mallrat dhe shërbimet ku do të thotë shëndetësia është që ka me së shumti mjete por ne jemi një organizatë buxhetore. Shërbimet publike e bëjnë dizinfektimin edhe objekteve arsimore edhe atyre shëndetësore nuk jon vetëm mjetet e shëndetësisë por përfiton edhe nga programet tjera 65 mijë duhet me i shpenzuar brenda këtij viti kalendarik, tjerat mbeten si pjesë e aseteve dhe barten ne vitin vijues.

**Kryetari i Komunës** – qëndron ajo që e tha drejtori, vërtet ka qen një angazhim i komplet staffi mjekësor edhe i drejtorit të Drejtorit të Shëndetësisë dhe drejtori i QKMF-së kanë funksionuar mirë, nuk kemi pasur ndonjë telashe të theksuar kështu ka funksionuar edhe lidhja me ju me Pejë shumë mirë, shumë pacient janë orientuar tek ju kanë mbajtur korrespondencë me ty, mendoj se gjithçka ka qenë mirë.

**Zenel Shatri** – në regjion jemi me të mirët.

Kryesuesi pasi që diskutime tjera nuk ka po e hedhe në votim  
Miratohet unanimit nga anëtarët e KPF-së.

**Vendimet:**

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF unanimit rekomandon Shqyrtimi i raportit të punës  
për 6 mujorin e NP "Ambienti", dhe të njëjtin ia kalohet KK për shqyrtim.

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

#### Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e gjashtë të rendit të ditës, Marrja e vendimit për formimin e komisioneve për ndarjen e bursave për vitin shkollor dhe për ankesa?  
Sqaron procedurat e këtyre dy komisioneve, ka dikush diçka rreth kësaj pike.  
Kush është që kjo pikë e rendit të ditës të dërgohet në Kuvend  
Unanimit miratohet të shkojë Kuvendit për shqyrtim.

**Diskutimet:**

**Vendimet:**

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja i rekomandon: Marrjen e vendimeve për formimin e komisioneve për ndarjen e bursave për vitin shkollor dhe për ankesa, si dhe i njëjti i kalohet KK-së për shqyrtim.

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

#### Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës, Shqyrtimi i kërkesës nr.00-016-23918 të datës 17.08.2020 nga K.R.M.- "Ambienti" - Istog?  
Sqaron procedurat e këtyre dy komisioneve, ka dikush diçka rreth kësaj pike.

**Zenel Shatri** - sa i përket rritjes së çmimit personalisht jam që ky çmim nuk bën të rritet në këtë kohë dhe në këto momente që krejt populli është në krizë ekonomike, edhe arsyetimin mund ta jap shumë të thjeshtë, nafta veç së është liruar, edhe materiali shpenzuese është ma lirë së çdo here jam që ky çmim të mbetet, edhe në Pejë është i njëjti çmim. Mendoj që në këtë moment është shumë e përsyeshme nuk po mendoj për në të ardhmen në këtë moment që të behet rritja e çmimit sado pak as një cent e jo pesëmbëdhjetë cent apo sa, nuk është koha as momenti me i shtrengu popullatën tonë sepse mund të mos i paguajnë hiq dhe të behet edhe me keq nuk është shumë e madhe por mendimi im është që të mos ngritët çmimi, të mbesin siç kanë qenë.

**Haki Podrimaj** - e mbështes doktorin z. Zenel. Ne para dy muajve e kemi pasur këtu raportin e NPL "Ambienti" për 6 mujorshin ajo e ka një afarizëm pozitiv, nuk do të thotë nëse e ka ngritë Klinën ta ngrisim edhe ne, si të kish qenë kompania në gjendje të mjerë ish dashtë ndoshta në këtë situatë mirë po pajtona me kolegun Zenel që deri në një kohë me të mirë të kalohet pandemia atëherë ne jemi këtu prapë i dirigjojmë këto çmime nuk do të thotë 0.35 cent që është një vlerë e madhe mirë po nuk na ka hije në këtë kohë edhe në këtë situatë ta ngrisim për arsye të shumta nuk jemi duke mundur të ju dalim në ndihmë aq sa duhet qytetarëve për shkak që e kemi një buxhet të reduktuar

barem ne mos ta ngarkojmë buxhetin e qytetarit. Edhe pse ka afarisem pozitiv, p.sh u përmend nafta ku në prill e në maj ka qenë 0.50 cent, kështu që kompania shpenzimet e norme i kanë nafte deh këtu kanë kursyer. Edhe ne jemi me i ndihmu kompanisë por një here është duke shkuar mirë.

**Kryesuesi i Kuvendit** - më falini që nuk ju njoftova se drejtori i ndërmarrjes Ambienti nuk ka mundur të jetë sot këtu në mbledhje për shkak se gjendet në pushime.

**Eliot Kukiqi** - edhe unë pajtona me koleget se vitin e kaluar ndërmarrja ka qenë 50 mijë euro pozitiv, ehe ato mjete shkojnë në regjion dhe këto mjete ne si komunë nuk mund ti shfrytëzojmë në fund.

**Kryesuesi i Kuvendit** - a dëshiron dikush fjale, Kryetar a ki diçka për të thënë rreth kësaj çështje.

**Kryetari i Komunës** - nuk kamë asgjë ju jeni ata që duhet ta vendosni dhe ju përkrahë. A bën kjo pikë të shtohet deri sa të kaloj pandemia nuk jam qe të ngritët as një çmim tani në kohë pandeminë.

**Kryesuesi i Kuvendit** - Pas diskutimeve që i patëm këtu kjo pik e rendit të ditësh nuk i kalohet Kuvendit për shqyrtim.

Unanim miratohet që kërkesa e NPL "Ambienti" mos të kalohet në Kuvend për shqyrtim.

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja i rekomandon që : kërkesa me Nr.00-016-2391/8 të datës 17.08.2020 nga K.R.M.- " Ambienti" - Istog, nuk kalohet në kuvend për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Diskutime tjera:

**Kryesuesi**, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj :

11:50

Procesmbajtëse,  
Znj. Vjosa Hysenaj



Kryesuesi i Kuvendit,  
z. Qaush Balaj

